

**VENDIM**  
**Nr.212, datë 11.3.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 29.7.2020, nr. 1131, datë 24.12.2020; nr. 204, datë 25.3.2021)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

*1.Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore (projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolektimin e këtyre objekteve) në vlerën, gjithsej, në masën 9 531 941 818 (nëntë miliardë e pesëqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, përkatësisht:*

*i. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën, gjithsej, 4 347 753 223 (katër miliardë e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë;*

*ii. Bashkisë Tiranë, në vlerën, gjithsej 5 184 188 593 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.*

*2. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, të jetë në masën 5 130 260 797 (pesë miliardë e njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga të cilat:*

*a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 4 125 706 878 (katër miliardë e njëqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH;*

*b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 004 553 919 (një miliard e katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH.*

*2.1 Përdorimi i fondit, për vitin 2021, do të jetë në masën 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, nga i cili Bashkisë Tiranë, për vitin 2021, i transferohet fondi prej 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit dhe mobilimit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë.*

**4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit**

**5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**